



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:093595

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876292

KPPP.nr.1018/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Vizatim Consulting L.L.C, me seli në Fushë Kosovë, rruga Uglar Blloku 6, me NUI: 810852857, kundër debitorit Media Press Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “Gjeravica”, me NUI: 810105230, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Xhevdet Smakiqi me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.35/22 të datës 02.02.2022, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datën 14.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Media Press Sh.P.K., ANULOHET Urdhri Përbarimor P.nr.35/22 i datës 02.02.2022, i nxjerrë nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.35/22 të datës 02.02.2022, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.21-SHV04-N01-118/2020 të datës 22.11.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit sipas faturës së lartëshënuar, të paguajë shumën prej 120.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, për shkak të shkeljeve të marrëveshjeve dhe marrëdhënieve detyrimore, shkeljeve procedurale ligjore, shkaktimit të dëmit që i ka bërë Media Press Sh.P.K., shkeljeve të së drejtës materiale, dhe mos vërtetimit të gjendjes faktike dhe juridike. Më tej ka theksuar se fatura e lëshuar nga debitori nuk është e bazuar në asnjë kontratë me shkrim ndërmjet palëve dhe nuk është e bazuar në kryerjen e shërbimeve të pretenduara në faturë. Ka shtuar se është e paligjshme se mbi çfarë baze ligjore Përmbaruesi Privat ka lejuar urdhrin përmbarimor të bazuar në faturë fiktive të njëanshme. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i përfaqësuesit me autorizim të debitorit, ndërsa të anulohet urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat, si dhe shpenzimet e procedurës të mbulohen nga kreditori.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, me arsyetimin se nga debitori vërehet qartazi se qëllimi i tij është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit, ngase asnjërin nga këto pretendime nuk e ka mbështetur në prova. Më tej ka theksuar se urdhri përmbarimor është i ligjshëm dhe i mbështetur në dokumente origjinale që kërkohen sipas dispozitave të LPP-së, duke shtuar se kreditori disa herë e ka paralajmëruar debitorin se lënda do të inicohet në përmbarim, mirëpo përkundër kësaj debitori asnjëherë nuk i është përgjigjur detyrimit të tij. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri i Përmbaruesit Privat, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e krijuara në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, sipas tarifave të parapara.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes*

së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.21-SHV04-N01-118/2020 e datës 22.11.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit– debitorit.

Duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori pa e kundërshtuar atë, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbarrimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1018/23, më datë 14.06.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.